



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Doretimi Prilipi/Prilipi Received/Delivety	22.04	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
BRANSHK	2343	2022	115	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.164/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.164/2022 të datës 24.02.2022 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_ kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në punë të datës 25.01.2022, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET ankesa me numër A.nr.164/2022 e datës 24.02.2022, e parashtruar nga ankuesja

II.ANULOHET vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën janar-dhjetor për vitin 2021, për ankuesen

III.OBLIGOHET Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021 për nëpunësen civile

IV.OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Ar sy e t i m

Ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, sipas akt emërimit me numër Nr.Ref: DSP 12/2013 të datës 01.04.2013 në pozitën “Zyrtare e lartë për analiza dhe planifikim”, në kuadër të Departamentit për Siguri Publike. Me datën 25.01.2022 Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 duke e vlerësuar ankuesen me notën e përgjithshme 2.93.

E pakënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, ankuesja me datën 24.02.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 973/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit vjetor të punës për vitin 2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 03.03.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datën 04.04.2022, Ministria e Punëve të Brendshme ka përcjellë shkresat për çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 944/2022 të datës 23.02.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit me numër Nr.01-112-44 të datës 04.01.2012 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; të datës 27.09.2012; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesin të datës 31.01.2022; Statutin me numër Nr.01/2020 të datës 30.09.2020 të Komunës së Pejës; ID kartelën e ankuesit me numër KPE-0286; Planin e punës për vitin 2021 nga ankuesi; Vendimin me numër Nr.Prot:112/01-46770/2020 të datës 05.06.2020 për emërimin e drejtorit të administratës; Vendimin me numër 01/016/01/130026 të datës 30.11.2021 për zgjedhjen e drejtorit të administratës në pozitën e kryesuesit të kuvendit të komunës së Pejës; Vendimin me numër Nr.Prot:112/01-2521/2022 të datës 10.01.2022 për emërimin e drejtorit të drejtorisë për administratë; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesin të datës 27.01.2021; E-mailin zyrtar të datës 31.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.03.2022 nga Komuna e Pejës lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesin; E-mailin zyrtar të datës 31.03.2022 lidhur me kërkesën për prova shtesë mbi ankesën e ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 31.03.2022 lidhur me përgjigjen në kërkesën për prova shtesë nga organi i punësimit; Raportin për periudhën 03.01.2021-31.12.2021 nga ana e zyrës ligjore lidhur me kryerjen e detyrave; Planin e punës për vitin 2021 nga zyra ligjore e Komunës së Pejës; Fletë dorëzimit e datës 11.01.2021 lidhur me planin e punës nga ana e drejtorit të administratës për ankuesin; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2021; Vendimin me numër Nr.Prot:01-016/01-122294 të datës 26.11.2021 për lirimin nga pozita e drejtorit të drejtorisë së administratës në komunën e Pejës; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2019 dhe 2020.

Me datën 08.04.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK.nr.25/2022, sipas të cilit i'a ka vazhduar afatin ankesës së ankueses të datës 24.02.2022 edhe për dhjetë (10) dite pune, për shkak të mungesës së provave nga ana e organit të punësimit si dhe nevojës për shqyrtim të mëtejshëm të çështjes.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankueses *Ë kthehet në rivlerësim, sepse:*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji ka analizuar nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publike, më të cilin përcaktohet se: *"1.Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit....."* si dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se: *"Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të paracaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar)",* rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se e njëjta sipas Raportit vjetor të punës për vitin 2021 të dorëzuar me shkresat e lëndës në Këshill nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, del se ka pasqyruar aktivitetet e realizuara gjatë periudhës së vlerësimit, duke listuar këto aktivitete për secilën fushë veç e veç si në vijim: tek fusha "Ngritja dhe përmirësimi i sigurisë publike", ka pasqyruar të gjitha aktivitetet të cilat janë realizuar lidhur me këtë fushë, tek fusha "Përmbushja e fushës legjislative" ka treguar hapat të cilat janë ndërmarrë lidhur me kryerjen e detyrave nga kjo fushë, e po ashtu edhe tek fushat si "Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore të institucioneve që ndikojnë në sigurinë publike" si dhe "Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve" janë listuar të gjitha aktivitetet të cilat janë ndërmarrë lidhur me ndërmarrjen dhe kryerjen e këtyre punëve, andaj bazuar në këto rrethana Kolegji vlerëson se vlerësimi i ankueses lidhur me rezultatet në punë për vitin 2021 me notën e përgjithshme 2.93, nga ana e udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë del se nuk është vlerësim real dhe objektiv.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave po ashtu ka analizuar përgjigjen e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses dhënë me datën 04.04.2022, i cili ka deklaruar ndër të tjera se ankuesja nuk ka arritur të përmbush detyrat e saj të punës dhe ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ka gjetur asnjë provë materiale lidhur me faktin së Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka shprehur pakënaqësi lidhur me mos kryerjen e detyrave të punës nga ana e ankueses, të ketë shqiptuar vërejtje në raport me mos përmbushjen e detyrave të punës apo se i njëjti ka kontribuar përmes dhënies së sugjerimeve dhe këshillave lidhur me përmirësimet e nevojshme të ankueses në përmbushjen e objektivave të punës, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitat e nenit 7 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike në të cilën precizohet se: *"Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të paracaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësimet e nevojshme",* andaj bazuar në rrethanat si më lartë rezulton se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ka pasur për detyrë që përgjatë gjithë vitit të përcjellë përmbushjen e detyrave nga ankuesja dhe të kërkojë nga e njëjta që të raportoj në baza javore apo mujore lidhur punët e realizuara, nëse konsideron se punët nuk janë përfunduar nga ana e ankueses gjegjësit





virtutes së saj. Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në faktet dhe në të lartcekurat, konstaton se ankuesja nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe në raport me arrijtjen e objektivave dhe sjelljeve profesionale siç parashihet me nenin 3 dhe 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë. Po ashtu nuk ka asnjë dëshmi nga mbikëqyrësi i saj që vlerësuesi pasi që ka përgatitur formularin të jetë takuar me ankuesen në mënyrë që të diskutohet lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë siç parashihet me nenin 8 paragrafin 1 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, në atë mënyrë që ankuesja të pajtohet apo të mos pajtohet lidhur me këtë vlerësim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave po ashtu ka analizuar edhe Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2019 dhe 2020, ku Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses për vitin 2020 të njëjtën e ka vlerësuar me notën e përgjithshme 4.32, ndërsa për vitin 2019 e njëjta është vlerësuar me notën e përgjithshme 4.00 dhe ka vlerësuar se e njëjta për vitet paraprake ka pasur vlerësim "shumë mirë" bazuar në nenin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkangjitura si nga ankuesja po ashtu edhe nga organi i punësimit, ka vendosur që ankuesën e ankueses ta kthen në rivlerësim, duke e obliguar Udhëheqësin e drejtpërdrejtë të ankueses, që të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021, për nëpunësen \_\_\_\_\_ si dhe me rastin e vlerësimit të rezultateve në punë t'a ketë për bazë përshkrimin e detyrave të punës së ankueses.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, obligon Udhëheqësin e drejtpërdrejtë të ankueses në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Sigurimin e Aviacionit civil pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të shqyrtoj të gjitha faktet dhe në bazë të të gjeturave të këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 për ankuesen, si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës ti zhvilloj në pajtim me përshkrimin e detyrave të punës së tij dhe këtë ta bëjë gjithsesi në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë. Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave obligon Sekretarin e Përgjithshëm të kësaj ministrie, që pas pranimin të këtij vendimi të Këshillit, ti ndërmerr hapat e nevojshëm lidhur me zbatueshmërinë e tij.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.164/2022, datë 22.04.2022

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



*Vendimi i dërgohet:*

- ❖ Ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme
- ❖ Udhëheqësit të Divizionit për Siguri të Aviacionit Civil dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

